

KIC, 25.08.1998, FDH-29509; UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427.

Abedin (Hysen) Shala

(20.05.1938, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, bujk, shtatë fëmijë)

Abedini me bashkëshorten Nexmijen, djemtë Vebiun dhe Xhavitin dhe familjet e tyre jetonin në shtëpinë familjare në *Rrugën e Rreshtanit/Raštanski put [Suharekë/Suva Reka]*. Nga muaji qershor i vitit 1998, situata në qytet ishte e tensionuar për shkak të pranisë së madhe të forcave speciale serbe në qytet dhe përreth. Në datën **23.08.1998**, rreth orës 17:00, e gjithë familja ishte e tubuar në shtëpi. Tek Abedini gjendej edhe i vëllai Hasani me familje. Abedini doli në ato çaste në oborr. Pas pak, tek ai u kthye Rexhepi, i cili ishte nisur për Studençan/Studençane. Nuk kaloi shumë kohë dhe dikush hapi zjarr mbi ta nga drejtimi i shtëpisë së Agim Shales, e cila ishte larg afro 50 metra. Abedinin e qëlluan për vdekje, ndërkaq Rexhepin vetëm e plagosën në këmbë dhe ai u strehua në brendi të shtëpisë. Pas pak, policët serb hyrën në shtëpi, i keqtrajtuat fizikisht anëtarët e familjes Shala dhe, në fund, i nxorën në rrugë. Një ditë më vonë dhe pas sigurimit paraprak të lejes nga policia serbe, djali i Abedinit, Nebihu me disa burra e kanë varrosur Abedinin në varrezat e Suharekës/Suva Reka.

Burimet: deklarata V.S, FDH-32550; deklarata A.H, FDH-10112; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D.00697, FDH-35626; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; *At least 2 Killed and 5 Wounded in Suhareka Area in the Past 24 Hours*, newsletter, KIC, 24.08.1998, FDH- 29504.

Jetish (Shaip) Sylaj

(1927, shqiptar nga Sllapuzhani/Slapuzane, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, tre fëmijë)

Forcat serbe e kanë bombarduar **Sllapuzhanin/Slapuzane** më **23.08.1998**. Nipi i madh i Jetishit u plagos në oborr dhe, pas kësaj, familja e Jetishit e mori arratinë nga fshati. Jetishi nuk deshi të lëvizte nga shtëpia e vet. Ishte në moshë dhe i palëvizshëm. Dhjetë

ditë më vonë, situata u qetësua për pak dhe djali i Jetishit, Shaipi, u kthye që ta vizitonte të atin. E ka gjetur shtëpinë e djegur. Mbetjet mortore të Jetishit ishin në brendi të shtëpisë. Po atë ditë, i ka varrosur ato te vendi i quajtur *Te ara e Bugunit/Kod Bugunove njive*. Në fillim të muajit korrik të vitit 1999, kur familjarët u kthyen nga mërgimi në Shqipëri, i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Jetishit në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata I.S, FDH-10672; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.D00697, FDH-35626; fotografi FDH-20985.

Bislim (Latif) Zekolli

(18.05.1953, shqiptar nga Bllaca/Blace, komuna e Suharekës/Suva Reka, daktilografist, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Bislimi aderoi në radhët e UÇK-së në muajin mars të vitit 1998. E ka themeluar njësitin në fshatin e vet, të cilin e quanin *Këpuçë/Cipela*. Ka rënë më **23.08.1998**, gjatë betejës me forcat serbe në **Bllacë/Blace**, te vendi i quajtur *Shelgjet e Bllacës/Vrbe Blaca*, kur në afërsi të tij eksplodoi një granatë. E kanë varrosur në natën mes datave 25 dhe 26 gusht 1998 në Bllacë/Blace. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Bislimit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan].

Burimet: <http://www.theranda.com/webi/typography.html#item12>, FDH-36833; ICTY, IT-02-54 (S. Milošević), Ex.241 A, FDH-5838; fotografi, FDH-20988; fotografi FDH-21012; SHFDUÇK, *Feniksët...5*, 71-74; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; UÇK, *Lista e deshmoreve...*, FDH-36427.

Vesel (Ramadan) Sopaj

(13.05.1938, shqiptar nga Suhareka/Suva Reka, rojtar, shtatë fëmijë)

Në mëngjesin e datës **23.08.1998**, Veseli ka shkuar në punë. Ishte i punësuar si rojë në depon e materialit ndërtimor, që gjendej jo larg shtëpisë së tij, në *Rrugën e Reshtanit/Raštanski put [Suharekë/Suva Reka]*. Po atë ditë, bashkëshortja dhe djemtë e Veselit e kanë braktisur qytetin.